

Nr. 1914 Prot.  
Datë 30.08.2024



Eyes Information

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
DREJTORIA RAJONALE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT VLORE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 765 Prot.

Vlorë, më 13.08.2024

Lënda: Kërkesë për shpallje njoftimi

Drejtuar: BASHKISË DELVINË

Në vijim të komunikimit që kemi patur me ju si institucion për të na siguruar ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së punës të Zyrës Vendore të Punësimit Delvinë, kërkesë për të cilën morëm përgjigje se nuk dispononi ambiente të përshtatshme për të na ofruar, ju bëjmë me dije se DRAKPA Vlorë ka nisur procedurën për marrjen me qira të ambjenteve për zyra.

Në këto kushte kërkojmë prej jush të na mundësoni shpalljen e një njoftimi për marrjen me qira të ambjenteve nga të tretët për nevoja të Zyrës Vendore të Punësimit Delvinë, të cilën e gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Saniela XHAFERI



## KËRKESË PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBJENTEVE NGA TË TRETËT PËR NEVOJA TË ZYRËS VENDORE DELVINË

Drejtoria e Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive njofton se kërkon të marrë me qira ambiente për ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës Vendore të Punësimit Delvinë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

### **I. Kriteret specifike të ambienteve objekt qiramarrje:**

- Ambient për zyra me sipërfaqe totale rreth 80 m<sup>2</sup>, ku duhet të përfshijë ambient të mjaftueshëm për mbarëvajtjen e punës, zyra (zyra për punonjësit, arkivë, zyrë pritje) dhe 1 tualet të (kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë).
- Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre.
- Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisura me matës të dedikuar të ujit dhe të energjisë elektrike.
- Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional.
- Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune.
- Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme për t'u shfrytëzuara nga qiramarrësi. Dera kryesore hyrëse në këto ambjente duhet të jetë me konstruksion të sigurt.
- Statusi juridik i pronës që do të merret me qera duhet të jetë në pronësi të pronarit (Objekti të jetë i hipotekuar dhe të ketë genplan).
- Vendndodhja e ambienteve duhet të jetë në qytetin e Delvinës dhe sa më pranë qendrës së qytetit, për të siguruar një bashkëveprim dhe komunikim efektiv ndërmjet Zyrës Vendore të Punësimit dhe qytetarëve të interesuar për shërbimet e ofruar nga kjo zyrë.
- Ambienti duhet të ketë mundësi ajrimi si dhe kushte higjieno - sanitare të mira, duke ofruar në tërësinë e tij imazhin e një zyre shërbimi funksionale dhe në shërbim të qytetarëve.
- Ambientet duhet të jenë të lira, në mënyrë që dorëzimi të bëhet i mundur pa vonesa nga njoftimi për lidhjen e kontratës.

### **II. Kriteret ligjore dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë ofertuesit qoftë individë, agjenci imobilare apo shoqëri tregtare që disponojnë ambiente për t'i ofruar me qira, janë:**

- Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gen – planin.

- Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim ligjor, lëshuar nga ASHK-ja.
- Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime ligjore të pashlyera.
- Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera.
- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
- Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
  - a. NIPT/NUIS, certifikatën e regjistrimit dhe ekstrakt historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
  - b. Vërtetim nga tatim taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
  - c. Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera.
  - d. Vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin.
  - e. Ofertën më shkrim të çmimit të qirasë së ambienteve në muaj, të nënshkruar nga ofertuesi.
  - f. Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët, e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin e marrjes së ambienteve me qira për zyra, për Zyrën Vendore të Punësimit Delvinë.
  - g. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.
  - h. Oferta duhet të përzgjidhet, pas plotësimit të kriterëve ligjore dhe kërkesave kualifikuese të përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qera, bazuar në çmimin më të ulët të ofruar nga të interesuarit/ofertuesit.

### **III. Afati i kontratës dhe përcaktimet financiare:**

- Afati i kontratës së qirasë do të jetë nga momenti i lidhjes së kontratës deri në datë 31.12.2024 me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.
- Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda ditës që palët do të bien dakort në kontratën më shkrim, kundrejt faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare.
- Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga Drejtoria Rajonale e AKPA në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë.
- Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga DRAKPA Vlorë.

- Çmimi i ofruar nga Ofertuesi/Qiradhënësi duhet të përcaktojë (oferta ekonomike) vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit të fuqi;

**Dorëzimi i dokumentave dhe ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda një jave nga data e publikimit të njoftimit, pranë DRAKPA Vlorë, e cila rezervon të drejtën e verifikimit të vend të ambienteve dhe paraqitjes së një vlerësimi për ambientet.**

- Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike [info.vlore@akpa.gov.al](mailto:info.vlore@akpa.gov.al).